

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6634  
E hënë, 20 qershor 2022  
çmimi 0.40

Arrestohen 67 refugjatë në kufi, donin të hynin ilegalisht nga Shqipëria në Kosovë | F. 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## EDI RAMA VIZITON FAMILJEN E ISH-PRESIDENTIT THAÇI NË BUROJË



Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar të dielën familjen e ish-presidentit Hashim Thaçi në Burojë të Skenderajt, i cili gjendet në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Rama është pritur nga

djali i ish-presidentit Thaçi, Endriti, familjarë të tjerë e miq të shumtë të Thaçit. Kryeministri shqiptar në këtë vizitë ishte i shoqëruar edhe nga ministra të kabinetit të tij qeveritar

MINISTRI I JASHTËM TURK, MEVLUT ÇAVUSOGLU, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NË KOSOVË

## TURQIA I OFRON PËRKRAHJE KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË KËSHILLIN E EVROPËS

Ministri i jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu, ka thënë të dielën në Prishtinë se Turqia e mbështet integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës si dhe integrimin e saj në institucione ndërkombëtare dhe organizata euroatlantike. Ai ka theksuar se Turqia e mbështet anëtarësimin e vendit tonë në Këshillin e Evropës dhe se Kosova është vend partner i NATO-s. Çavusoglu, po ashtu, ka thënë se synojnë investime në Kosovë dhe se po i shohin mundësitë, veçanërisht për investime në fushën e energjisë



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### AKTUALE



NATO: LUFTIMET NË UKRAINË MUND TË ZGJASIN ME VITE F. 2

QEVERIA: KOMISIONI I VENECIAS JEP DRITËN E GJELBËR PËR VETING NË DREJTËSI F. 6

SOT MBLEDHJA E DY QEVERIVE KOSOVË - SHQIPËRI, POLICIA ANGAZHONET PËR OFRIMIN E SIGURISË F. 3



### EKONOMI



KOSOVARËT SI INVESTITORË TË HUAJ F. 7

### SPORT



NË KISHNICË DO TË NDËRTOHET KAMPI MULTIETNIK F. 9

## NATO: Luftimet në Ukrainë mund të zgjasin me vite

BRUKSEL, 19 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s ka paralajmëruar se lufta në Ukrainë mund të vazhdojë me vite. Ai ka kërkuar furnizim me armë të fundit për Kievit, edhe nëse "kostot janë të larta". Paralajmërimet erdhën pasi Rusia rriti ofensivën kundër Severodonjeckut dhe qyteteve të tjera lindore të Ukrainës. "Ne duhet të përgatitemi për faktin se lufta mund të marrë vite. Ne nuk duhet të heqim dorë nga mbështetja e Ukrainës", tha sekretari i përgjithshëm i

NATO-s, Jens Stoltenberg, më 19 qershor, për gazetën gjermane "Bild am Sonntag". "Edhe nëse kostot janë të larta, jo vetëm për mbështetjen ushtarake, edhe për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë dhe ushqimeve". Pas vizitës së tij në Kiev më 18 qershor për të treguar mbështetje për Ukrainën, kryeministri britanik Boris Johnson shkroi në "Sunday Times" të Londrës se "koha është faktori jetik" dhe "gjithçka do të varet nga fakti nëse Ukraina mund ta

forcojë aftësinë e saj për ta mbrojtur tokën e saj më shpejt se Rusia mund ta rinovojë kapacitetin e saj për të sulmuar".

Më 17 qershor Komisioni Evropian ka rekomanduar dhënien e statusit të vendit kandidat për Ukrainën.

Rekomandimet e 17 qershorit të KE-së do të diskutohen nga liderët e BE-së gjatë takimit më 23 dhe 24 qershor në Bruksel, ku do të merret vendimi përfundimtar për rekomandimet e Komisionit Evropian.



## Kievi: Rusët po përpigjen ta bëjnë Harkivin "qytet të vijës së parë të frontit"

KIEV, 19 QERSHOR - Një këshilltar i ministrit të Brendshëm të Ukrainës më 19 qershor përmendi një rrezik të shtuar në veri të qytetit të dytë më të madh të Ukrainës, Harkiv, pasi trupat ruse kërkojnë ta bëjnë atë "qytet të vijës së parë të frontit". Vadym Denysenko i tha televizionit kombëtar ukrainas se forcat armike po kërkojnë t'i afrohen Harkivit në verilindje të Ukrainës, në përpjekje për ta bombarduar atë. "Rusia po përpigjet ta bëjë



Harkivin qytet të vijës së parë", tha ai. Harkivi është një qytet kryesisht rusishtfolës me

rreth 1.4 milion banorë. Ai shtrihet rreth 30 kilometra nga kufiri rus.

Javën e kaluar raportet sugjeruan se forcat ruse kishin vendosur artileri për të penguar një kundërofensivë ukrainase pranë Harkivit.

Amnesty International pretendoi javën e kaluar se trupat ruse kishin zhvilluar "një fushatë të pamëshirshme bombardimesh kundër Harkivit".

Raporti tha se "shumë nga sulmet [ruse] u kryen duke

përdorur municione të ndaluara gjerësisht".

Harkivi, qyteti që ndodhet në skajin verilindor të Ukrainës pranë kufirit rus, u bombardua rëndë nga forcat e Moskës.

Rusia ka nisur pushtimin e paprovokuar të Ukrainës më 24 shkurt. Presidenti rus, Vladimir Putin, e ka cilësuar si "operacion special".

Perëndimi e ka dënuar ashpër pushtimin dhe ka vendosur një varg sanksionesh të rënda kundër Rusisë.

## Gjermania merr masa për shkurtrimin e përdorimit të gazit rus

Berlin, 19 qershor - Ministri gjerman i Ekonomisë, Robert Habeck, po përgatit masa të mëtejshme për ta frenuar konsumin e gazit natyror dhe për t'u larguar nga furnizimet tashmë të shkurtuara të gazit rus, raporton agjencia gjermane të lajmeve dpa. Ai tha se qeveria në Berlin po ofron miliarda euro financim për ta mbështetur shkurtrimin e përdorimit të gazit për energji dhe industri.

"Objektet e magazinimit gjithashtu do të mbushen më tej përpara fillimit të dimrit", tha ai.

Thuhet se termocentralet me qymyr do të ndihmonin në kompensimin e mungesës.

Një projektligj i miratuar nga qeveria gjermane siguron që termocentralet me qymyr që ishin planifikuar të mbylleshin më parë të mbeten në gjendje funksionale.

Gjiganti i gazit rus, "Gazprom", njoftoi për shkurtime të përsëritura këtë javë të dërgesave të saj përmes gazsjellësit Nord Stream 1 në Gjermani, duke përmendur probleme teknike.

Ministri gjerman i Ekonomisë, Robert Habeck, e quajti këtë veprim një "vendim politik dhe jo një zgjidhje teknike".



Evropianët kanë vendosur sanksione financiare, udhëtimi, diplomatike dhe të tjera ndaj Rusisë që kur presidenti Vladimir Putin

urdhëroi dhjetëra mijëra trupa ruse në Ukrainë më 24 shkurt, në pushtimin më të madh të huaj të Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore.

Gjermania është tradicionalisht një nga klientet më të mëdha të gazit në Rusi.

"Gazprom" tashmë ka ndërprerë furnizimin për Bullgarinë, Poloninë, Finlandën, Holandën dhe Danimarkën.

## Anëtarët e Shtetit Islamik marrin përsipër sulmin në Kabul

KABUL, 19 QERSHOR - Një degë rajonale e grupit militant të Shtetit Islamik (IS) ka marrë përgjegjësinë për një sulm në një tempull të Sikhëve në kryeqytetin afgan. Një sulm në një tempull të Sikhëve në Kabul la të vdekur të paktën dy persona dhe plagosi shtatë të tjerë, më 18

qershor, pas shpërthimit të një makine të mbushur me eksploziv.

Shteti Islamik në provincën Khorasan, një degë rajonale e grupit IS, ka shtuar së fundmi sulmet ndaj xhamive dhe pakicave në të gjithë Afganistanin.

Grupi tha përmes "Telegram"-



it se sulmi ishte një përgjigje ndaj fyerjeve kundër profetit

Muhamed. Zyrtarët qeveritarë të udhëhequr nga talebanët thanë se një besimtar i komunitetit Sikh ishte vlarë në sulm dhe një anëtar i forcave talebane u vra gjatë operacionit të pastrimit. Vëzhguesit ndërkombëtarë janë ankuar për mungesën e

sigurisë për minoritetet Sikh, Sufi dhe Hazara të Afganistanit. Raportuesi special i OKB-së për Afganistanin, Richard Bennett, "dënoi fuqishëm" sulmin dhe kërkoi të ndalohen "sulmet sistematike ndaj pakicave fetare në Afganistan". Sulmi u dënua edhe nga Bashkimi Evropian.

# Arrestohen 67 refugjatë në kufi, donin të hynin ilegalisht nga Shqipëria në Kosovë

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Policia kufitare e Kosovës dhe e Shqipërisë kanë arrestuar 67 refugjatë të cilët po tentonin të hynin ilegalisht në territorin e Kosovës nga Shqipëria. Lajmin e ka dhënë Policia e Kosovës, duke theksuar se Policia Kufitare e Kosovës po bashkëpunon ngushtë me autoritetet kufitare shqiptare për menaxhim efikas të kufirit shtetëror. "Sot, më 19.06.2022, rreth orës 16:50, Policia Kufitare (DRPK), konkretisht

Stacioni Policor për mbikëqyrje kufitare - SPMK Vermicë, ka pranuar informata se në vijën e gjelbër të pjesës së Republikës së Shqipërisë, në drejtim të Kosovës, janë vërejtur dhjetëra refugjatë. Me të pranuar informacionin menjëherë, në bashkëpunim dhe bashkëveprim me policinë homologe shqiptare, është hartuar një plan taktik për parandalimin e tyre që mos të lejohen të hyjnë në territorin e Kosovës. Sipas informacioneve,

patrullat homologe të Policisë së Shqipërisë deri më tani kanë ndaluar 67 shtetas të huaj (refugjatë) ilegalë dhe janë duke u marrë me trajtimin e tyre", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Po ashtu, është bërë me dije se autoritetet policore kufitare janë duke bashkëpunuar ngushtë për zbulimin e mundshëm të ndonjë personi/personave të cilët mund të kenë qenë duke i kontrabanduar viktimat në fjalë.



# Sot mbledhja e dy qeverive Kosovë - Shqipëri, policia angazhohet për ofrimin e sigurisë



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Sot (e hënë) në Prishtinë do të mbahet takimi i radhës mes dy qeverive, asaj të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Policia e Kosovës do të kujdeset për ofrimin e sigurisë dhe mbajtjen e rendit e qetësisë publike gjatë kohës së zhvillimit të mbledhjes dhe gjatë lëvizjes së kryeministrit dhe ministrave të Qeverisë së Shqipërisë. "Në kohën e ardhjes së përfaqësuesve shtetërorë nga Shqipëria, për t'i mundësuar qarkullim të lirë të eskortës zyrtare nën përcjellje dhe sigurim, Policia e Kosovës sot në orët e pasdites (19.06.2022) dhe nesër (20.06.2022) sipas itinerarit të

lëvizjes së personaliteteve/delegacioneve do të bëjë ndërprerje të përkohshme në intervale të shkurta kohore të qarkullimit të trafikut në disa segmente rrugore ku pritet të kalojnë delegacionet", thuhet në njoftimin për medie.

Për ta mundësuar qarkullimin dhe riorientimin e trafikut në rrugë alternative në lokacionet ku pritet të kalojë eskorta do të angazhohen zyrtarë policorë të njësiteve relevante, andaj Policia e Kosovës kërkon mirëkuptim të plotë nga qytetarët dhe pjesëmarrësit në trafik.

Mbledhja e dy qeverive do të fillojë në orën 11:15 në hotel "Garden" në Prishtinë.

# Meta: Rritja e çmimeve sjell një kërcënim real

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, iu adresua sesionit përmbyllës të Forumit IX Global të organizuar nga Qendra Ndërkombëtare "Nizami Ganjavi" në Baku të Azerbajxhanit, me temë "Sfidat ndaj rendit botëror". Duke iu drejtuar shumë personaliteteve të nderuara të pranishëm, presidenti Meta u shpreh se bota ka nevojë urgjente për paqe dhe siguri,

por kjo kërkon një udhëheqje të përgjegjshme dhe të mençur.

Ai theksoi se lufta në Ukrainë ka shkaktuar situatën më të rrezikshme dhe më të paqëndrueshme që nga Lufta e Dytë Botërore dhe kjo ka ndikuar rëndë sigurinë në shkallë globale. "Puna për çështjet e sigurisë, duke përfshirë sigurinë e shëndetit, ushqimit ose energjisë, duhet të jetë fokusi ynë për të ardhmen dhe se si mund të

ecim përpara", u shpreh Meta. Ai theksoi në fjalën e tij se rritja e çmimeve të ushqimeve sjell një kërcënim real në rritjen e varfërisë, që mund të sjellë zi buke, veçanërisht në disa zona të botës, si Afrika, dhe që mund të përshkallëzohet në një krizë të vërtetë humanitare, politike dhe migrim masiv në botë. "Koha po na mbaron!", tha presidenti Meta duke shtuar: "Mësimi i nxjerrë është se popujt që flenë në demokraci, zgjohen në diktaturë".



## 15 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 249 testeve, 15 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të dielën janë shëruar 10 qytetarë, ndërsa numri i

përgjithshëm i të shëruarve është 225 292.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 106. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 5 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës

janë dhënë 1 830 154 doza të vaksinës.

Deri më sot 823 550 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Po ashtu, deri më sot janë dhënë 103 073 doza të forcuara dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



MINISTRI I JASHTËM TURK, MEVLUT ÇAVUSOGLU, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NË KOSOVË

## Turqia i ofron përkrahje Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës

Ministri i jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu, ka thënë të dielën në Prishtinë se Turqia e mbështet integritetin territorial dhe sovranitetin e Kosovës si dhe integrimin e saj në institucione ndërkombëtare dhe organizata euroatlantike. Ai ka theksuar se Turqia e mbështet anëtarësimin e vendit tonë në Këshillin e Evropës dhe se Kosova është vend partner i NATO-s. Çavusoglu, po ashtu, ka thënë se synojnë investime në Kosovë dhe se po i shohin mundësitë, veçanërisht për investime në fushën e energjisë. Gjatë kësaj vizite Kosova dhe Turqia kanë nënshkruar marrëveshje në fushën e aviacionit, sipas së cilës, do të rritet numri i frekuencave të fluturimeve ndërmjet dy shteteve

fluturimeve ndërmjet dy shteteve. Marrëveshja është nënshkruar nga ministri i Jashtëm turk, Çavusoglu, dhe ministri i Infrastruktura të Kosovës, Liburn Aliu.

### Osmani vlerëson mbështetjen e Erdoganit ndaj anëtarësimit të Kosovës në NATO

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlut Çavusoglu, me të cilin kanë zhvilluar një bisedë përmbajtjesore dhe kanë konfirmuar raportet e shkëlqyera ndërshtetërore.

Me ministrin Çavusoglu presidentja Osmani diskutoi për bashkëpunimin bilateral, në fushën e politikës së jashtme, mbrojtjes, tregtisë dhe fusha të tjera të interesit të dyanshëm.

Osmani dhe ministri Çavusoglu diskutuan edhe për zhvillimet aktuale në rajon dhe në Evropë, me ç'rast presidentja Osmani potencoi se integrimi i rajonit të Ballkanit Perëndimor në strukturat euroatlantike parandalon ndikimin rus në rajon dhe tendencën për destabilizim. Në këtë kontekst, presidentja Osmani ka përsëritur qëndrimin se anëtarësimi i Kosovës dhe rajonit në strukturat

euroatlantike është domosdoshmëri. “E vlerësoj maksimalisht mbështetjen e qartë të presidentit Erdogan ndaj anëtarësimit të Kosovës në NATO dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Mbështetje nga Turqia na duhet edhe për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës”, ka theksuar Osmani, duke shtuar se marrëdhëniet e Kosovës me Turqinë janë strategjike dhe se ky shtet është ndër partnerët tanë kryesor në NATO. “Komuniteti turk në Kosovë dhe mërgata e madhe shqiptare në Turqi janë urë e fortë ndërmjet dy shteteve”, ka theksuar presidentja Osmani. Marrëdhëniet ndërmjet të dy shteteve, sipas presidentes Osmani, kanë potencial të thellohen edhe më tej, posaçërisht në fushën e investimeve, si dhe duke rritur eksportin e Kosovës në Turqi.

### “Republika e Turqisë është partnere, mike dhe aleate e madhe e Republikës së Kosovës”

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, priti në takim ministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë, Mevlut Çavusoglu. “Republika e Turqisë është partnere, mike dhe aleate e madhe e Republikës së Kosovës”,

**EPOKA E RE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Zëvendëskryeministrja, njëherësh ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e ka pritur të dielën në takim homologun e saj, ministrin e jashtëm turk, Mevlut Çavusoglu. Në konferencën mbajtur pas takimit, ministrja Gërvalla e ka falënderuar homologun turk për mbështetjen që shteti i tij i ka dhënë Republikës së Kosovës në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe në shumë fusha të tjera. Gërvalla ka thënë se “gjithnjë është kënaqësi të presësh një homolog dhe një mik të mirë të Kosovës i cili e njeh mirë historinë e shtypjes dhe gjenocidit në Kosovë dhe, në të gjitha lëvizjet e tij, nuk e harron përvojën jo vetëm historike, por edhe shumë të freskët të gjenocidit në rajon”. Duke folur për zhvillimet në rajon, me theks të veçantë për

situatën në Ukrainë, ministrja Gërvalla ka thënë se Republika e Kosovës i vlerëson Rusinë dhe Serbinë si faktorë destabilizues. “Pozicioni i Kosovës në këtë çështje është i qartë: Rusinë, por edhe Serbinë, i shohim jo vetëm si faktorë agresivë, por edhe destabilizues për gjithë rajonin tonë. Shpresojmë që përpjekjet për ndërmjetësim të Bashkimit Evropian, të NATO-s, por edhe të Turqisë, do të kontribuojnë që Serbisë dhe separatistëve serbë në Bosnjë dhe Hercegovinë t’u pamundësohet që, nën hijen e agresionit rus në Ukrainë dhe me ndihmën e Rusisë, t’i destabilizojnë Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Juglindore”, ka thënë Gërvalla. Shefja e diplomacisë, gjithashtu, ka thënë se me homologun turk ka biseduar edhe për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve, për krijimin e mundësive për më shumë investime direkte turke në

Kosovë dhe për përdorimin maksimal të potencialit të ofruar në kuadër të marrëveshjes së tregtisë së lirë e cila ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2019. Ministri Çavusoglu, duke e falënderuar ministrin Gërvalla për mikpritjen, ka theksuar se Republika e Kosovës është vend mik dhe se shteti i tij e mbështet rrugën euroatlantike të Kosovës. “Dua ta përsëris qëndrimin tonë për mbështetjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës, si dhe integrimin e saj në institucione ndërkombëtare dhe organizata euroatlantike”, ka thënë Çavusoglu. Ai, po ashtu, ka thënë se synojnë investime në Kosovë dhe se po i shohin mundësitë, veçanërisht për investime në fushën e energjisë. Kosova dhe Turqia, paraprakisht, nënshkruan marrëveshje në fushën e aviacionit, sipas së cilës, do të rritet numri i frekuencave të

# Edi Rama viziton familjen e ish-presidentit Thaçi në Burojë

EPOKA  
ERE

M. QORRAJ

SKENDERAJ, 19 QERSHOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka vizituar të dielën familjen e ish-presidentit Hashim Thaçi në Burojë të Skenderajt, i cili gjendet në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Rama është pritur nga djali i ish-presidentit Thaçi, Endriti, familjarë të tjerë e miq të shumtë të Thaçit.

Kryeministri shqiptar në këtë vizitë ishte i shoqëruar edhe nga ministra të kabinetit të tij qeveritar.

Rama, i cili gjendet në Kosovë për ta zhvilluar takimin ndërqeveritar Kosovë - Shqipëri të hënën, vizitën e tij e nisi me vizitën në disa biznese dhe në shtëpinë e ish-presidentit Thaçi.

Kryeministri shqiptar, Edi Rama, kohën e fundit ka vizituar ish-presidentin Hashim Thaçi në Hagë. Pas kësaj vizite në Hagë,



Rama ishte deklaruar për medie: "Ishte një çmallje e nevojshme. Presidentin Thaçi e gjeta në top formë, i bindur mbase dhe më shumë se kur e kam takuar më parë se të vinte këtu, se kjo ishte një rrugë e pashmangshme për të provuar katërçipërisht përpara drejtësisë, pastërtinë e plotë të luftës çlirimtare dhe natyrisht edhe pastërtinë e idealit të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare

Kosovës, të udhëheqësve të UÇK-së. Natyrisht që të gjithë në jemi të bindur se lufta çlirimtare e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe as nuk mund kurrsesi të futet në korniza të tjera sepse ajo është tanimë e futur në kornizën e artë të heroizmit, sakrificave, e gjatë të dhënë dhe, natyrisht, e të gjitha përpjekjeve që kanë vijuar më tej në Kosovën e lirë dhe sovranë".



tha kryeministri Kurti, ndërsa shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhënë vendit tonë.

Ministri Çavusoglu theksoi mbështetjen e Republikës së Turqisë për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës sikurse edhe për

anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ai tha se Turqia e mbështet anëtarësimin e vendit tonë në Këshillin e Evropës dhe se Kosova është vend partner i NATO-s. Po ashtu, theksoi se Republika e Turqisë e ka shumë të rëndësishme paqen dhe stabilitetin dhe se nuk do të

lejojë që rajoni i Ballkanit të kthehet në vitet e errëta të '90-ta.

Ministri turk vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera bilaterale, rritjen e bashkëpunimit ekonomik dhe të investimeve. Duke potencuar stabilitetin institucional dhe indikatorët pozitivë ekonomikë,

kryeministri Kurti ritheksoi përkushtimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për nxitjen e investimeve nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social dhe luftimit të krimit dhe korrupsionit. Ai veçoi synimin e Kosovës për anëtarësim në Partneritetin për Paqe të NATO-s, ndërsa theksoi

mundësitë për rritje të bashkëpunimit në mbrojtje dhe siguri.

U diskutua për shumë fusha të bashkëpunimit në ekonomi, energji, siguri dhe mbrojtje. U vlerësuan lidhjet e shumta mes dy vendeve, duke veçuar ato mes qytetarëve, që janë një urë për marrëdhëniet e forta dypalëshe.

# Qeveria: Komisioni i Venecias jep dritën e gjelbër për veting në drejtësi

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Pas vlerësimit të Komisionit të Venecias për konceptdokumentin e Qeverisë së Kosovës për veting në drejtësi dhe projektligjit të Byrosë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, Kosova do ta nisë zbatimin e këtyre dy proceseve, kështu tha kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në një konferencë për medie, ku bashkë me ministrin e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, folën për opinionet e Venecias. "... vetingu është i domosdoshëm, porsia edhe konfiskimi i pasurisë i fituar në mënyrë të paligjshme. Sot fillojmë jetësimin e punës njëvjeçare të Ministrisë së Drejtësisë për realizimin e këtyre proceseve jetike për Kosovën, me përkrahjen e Komisionit të Venecias", tha Kurti. Sipas tij, gjithçka që kërkohet nga Qeveria e Kosovës do t'i dërgohet Kuvendit në afat rekord.

Qeveria e Kosovës më 13 tetor kishte miratuar konceptdokumentin për vetingun në drejtësi përmes të cilit synohet të forcohet sundimi i ligjit.

Vetingu është proces i rivlerësimit të figurës së prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe ka për qëllim rritjen e tyre profesionale, luftimin e korrupsionit dhe ndikimin e kimit të organizuar, politikës apo elementëve të tjerë të paligjshëm në dhënien e drejtësisë.

Ndërsa për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë, Komisioni i Venecias, sipas Kurtit, ka kërkuar edhe zgjerim të kompetencave.

Ekzekutivi kishte thënë se subjekti i Byrosë do të ishin të gjithë zyrtarët publikë, ndaj të cilëve ekzistojnë dyshime se pasuria e tyre është fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, tha se ky komision ka



arrihet rezultati i synuar për një gjyqësor me integritet profesional dhe efikas. "Komisioni rekomandon fillimisht verifikimin e niveleve të larta në gjyqësor dhe në prokurori përmes një mekanizimi të jashtëm, pra nivele të larta duke filluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe kryetarëve të të gjitha gjykatave dhe kryeprokurorëve të të gjitha prokurorive".

Duke cituar opinionin e këtij komisioni, ministrja e Drejtësisë tha se "Komisioni konstaton se në kontekstin e Kosovës një veting efektiv do ta kërkonte kombinimin e masave të ndryshme që do të kenë efekt pozitiv në integritetin dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë". Ndërsa sa i përket Projektligjit për

Byronë për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, Haxhiu thotë se, sipas komisionit, "konfiskimi civil mund të jetë i dobishëm". "Pra Komisioni i Venecias njeh mekanizmin për konfiskimin me bazë civile dhe jep se si një mekanizëm i tillë do të duhej fuqizuar dhe i cili do të ishte kompetent për verifikimin fillestar dhe më pas konfiskimin përfundimtar do ta bëjë gjykata. Veting do të ketë dhe të plotë, duke filluar nga krerët e institucioneve të drejtësisë", tha Haxhiu.

E pyetur se si do të zgjidhet drejtori i Byrosë për Konfiskimin e Pasurisë, ajo tha se Venecia ka rekomanduar që të rishikohen emrat e komisionit përzgjedhës, mirëpo për ta fuqizuar institucionin është rekomanduar

që komisioni që dërgon emrat të ketë përfaqësues të institucioneve të pavarura. Projektligji për Byronë kërkon votimin e shumicës së thjeshtë në Kuvendin e Kosovës, ndërsa për veting me ndryshime Kushtetuese, ku kërkohen dy të tretat e votave, Haxhiu tha se duhet konsensus dhe se shpreson në bashkëpunimin e partive opozitare.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës më herët kishin thënë se Kosovës i duhet veting sistematik në drejtësi. Ndërkaq Komisioni Evropian kishte kritikuar planin e Qeverisë së Kosovës për të bërë veting "të njëhershëm të të gjithë prokurorëve dhe gjyqtarëve", duke thënë se ky do të ishte "burim serioz i shqetësimit".

## Përfundon Provimi i Maturës 2022, mbi 100 nxënës përjashtohen shkak i telefonave



**PRISHTINË, 19 QERSHOR (ER)** - Komisioni Shtetëror i Maturës ka njoftuar se ka përfunduar me sukses Provimi i Maturës 2022 të cilit iu nënshtruan rreth 22 mijë maturantë.

Provimi i Maturës këtë vit është organizuar në 171 qendra të testimit, ndërsa të angazhuar për mbarëvajtje të procesit ishin të angazhuar rreth 1 600 administrues.

KShM ka falënderuar të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e testimit për kontributin e tyre në mbarëvajtje të procesit.

KShM njofton se Provimi i Maturës ka filluar me kohë, përveç në rastet ku ka pasur vonesa të

administruesve dhe vonesa të nxënësve për shkak të posedimit të telefonave.

Ndër të tjera, KShM bën të ditur se, sipas raporteve të administratorëve, në disa qendra ka pasur largim të nxënësve nga provimi për shkak të përdorimit të telefonave, pra mbi 100 nxënës.

Për disa nxënës provimi do të përsëritet ngaqë lënda zgjedhore nuk është përshtatur me zgjedhjen e nxënësit.

Sa i përket numrit të saktë të nxënësve si dhe të dhënave të tjera rreth administrimit, KShM-ja do të raportojë pas përpunimit të të gjitha raporteve nga të gjitha qendrat e testimit në nivel vendi.

# Kosovarët si investitorë të huaj

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Flamur Mavraj dhe Burim Hazrolli vijnë nga qytete të ndryshme të Kosovës, por kanë të njëjtin fat: të dy janë dëbuar nga shtëpitë gjatë luftës së viteve 1998/99. Sot të dy njihen si afaristë të suksesshëm në vendet që ua kanë hapur dyert si refugjatë.

Mbi dy dekada më parë familja e Mavrajt nga Istogu është zhvendosur në Norvegji, ndërsa familja e Hazrollit nga Malisheva ka gjetur strehim në Gjermani. Flamuri është shkolluar në fushën e teknologjisë së informacionit, ndërsa Burimi ka zgjedhur sektorin e ndërtimit dhe prodhimit.

Të dy prej vitesh i kanë shtrirë investimet e tyre edhe në Kosovë, por thonë se sfidat për të arritur deri këtu nuk kanë qenë të pakta - nisur nga barrierat në gjuhën e vendit mikpritës deri te një mentalitet ndryshe i tij. "Si një person në një vend të huaj, sfida kryesore ka qenë mësimi i gjuhës norvegjeze, pastaj integrimi", thotë Flamuri, i cili në kohën kur është zhvendosur në Norvegji ka qenë 12 vjeç.

"Jam ndier i huaj edhe aty ku banoja, edhe kur vija në Kosovë", rrëfen ai për "Radion Evropa e

Lirë".

Flamuri, sot 35 vjeç, thotë se me kalimin e kohës, e ka kuptuar se dëshiron të orientohe në fushën e teknologjisë së informacionit.

Pas mbarimit të studimeve në Oslo, ai thotë se ka hapur kompani të veten në këtë qytet, në vitin 2006. Nga ajo kohë, thotë se e ka vizituar Kosovën edhe më shpesh, ku ka krijuar kontakte dhe ka marrë pjesë në organizime të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit. Nga viti 2015, kompaninë e tij e ka zgjeruar me një zyrë edhe në Kosovë, ku tani ka të punësuar dhjetë veta.

Sipas tij, tregu i punës në Kosovë, është duke ecur në drejtim të duhur, por mendon se ende ka punë. "Gjërat nuk ndryshojnë brenda ditës. Ne që jetojmë e veprojmë jashtë vendit presim që (gjërat) të funksionojë në Kosovë njëjtë siç funksionon p.sh në Norvegji, por duhet kuptuar se Kosova është shtet i ri krahasuar me vendet tjera", thotë ai.

Si investitor i huaj në Kosovë, por me prejardhje shqiptare, Flamuri thotë se ka përparësi, pasi flet gjuhën e njëjtë me punëtorët dhe njeh kulturën dhe mentalitetin e popullit të tij. "Të gjitha projektet i

marrim në Norvegji, e pastaj puna bëhet në Kosovë", thotë ai.

Burimi, në anën tjetër, nga Kosova është zhvendosur në Gjermani si 16-vjeçar. Gjashtë vjet më vonë, ka hapur kompaninë e cila, siç thotë, merret me ndërtimin dhe shitjen e objekteve.

Sot, ajo ka më shumë se 150 të punësuar dhe mbi 100 kompani nënkontraktuese.

Nga viti 2019, biznesin e tij e ka shtrirë edhe në vendlindje. Kompania e tij në Suharekë prodhon dyer, dritare, fasada strukturale e të tjera, dhe k të punësuar 35 punëtorë.

Ai thotë se deri në 95 për qind e këtyre produkteve eksportohen në vende të ndryshme, ndërsa 5 për qind mbeten për tregun e brendshëm.

Që një produkt i prodhuar në Kosovë të arrijë tregun ndërkombëtar, kompania duhet pajisur me disa certifikata të ndryshme ndërkombëtare të cilësisë dhe sigurisë, varësisht nga produktet që prodhojnë.

Burimi thotë se synon të zgjerohet. "Unë jam duke e hulumtuar tregun dhe këtë vit kam mundësi të hap edhe një fabrikë tjetër. Qëllimi im është që në pesë deri në dhjetë vjetët e ardhshëm t'i hap edhe pesë

fabrika", thotë Burimi.

Për të zgjeruar investimet në Kosovë, ai thotë se institucionet duhet të ofrojnë kushte më të mira për investitorët. Ai pretendon se në mesin e diasporës ka të interesuar për të investuar në Kosovë, por, sipas tij, ambienti afarist duhet të jetë më i përshtatshëm. "Kam sjellë investitorë në Kosovë vite më parë, por kam dështuar. Kam dështuar, sepse në atë kohë kanë kërkuar përqindje në kompani [mito]. Kam pasur rast kur edhe mua më kanë kërkuar përqindje - para 15 vjetësh", thotë Burimi.

Jo rrallë në Kosovë është thënë se remitencat, apo dërgesat e parave nga diaspora, duhet të orientohehin në projekte investuese.

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, vetëm vitin e kaluar, remitencat kanë kapur vlerën e rreth 1.2 miliard eurove.

Qeveria aktuale e Kosovës, e cila ka marrë detyrën në mars të vitit të kaluar, në programin qeverisës për vitet 2021 - 2025 ka paraparë promovimin dhe përkrahjen e investimeve të huaja. Në këtë aspekt, qeveria në program ka paraparë që vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së diasporës në investime.

Sipas programit, kjo do të bëhet me anë të organizimit të konferencave dhe sesioneve informuese, krijimit të fuqizimit të rrjeteve të afarizmit me investitorë potencialë, duke hulumtuar dhe përcaktuar vendet me potencial për të promovuar mundësitë për investime.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në forumin e bizneseve të diasporës të mbajtur muajin e kaluar, u ka bërë thirrje bizneseve të diasporës që të investojnë në Kosovë si një mundësi përfitimi. "Pra, ejani, kontribuoni dhe fitoni! Nuk jemi në të kaluarën, kur kemi bërë thirrje për kontribut përmes sakrificës, por për kontribut përmes fitimit, përmes përfitimit, përmes fitimit të dyanshëm, edhe për mërgatën tonë, si qytetarë të vendit tonë e pjesëtarë të kombit tonë, edhe për shtetin tonë demokratik dhe zhvillimit e tij socio-ekonomik", ka thënë Kurti.

Por, krijimi i një ambienti më të mirë afarist për investitorët e huaj ishte kërkuar vazhdimisht edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë si Banka Botërore.

Një nga vërejtjet e bëra nga Banka Botërore ishte procedura burokratike.



# Evropa duhet të mësojë të mbrohet vetë: Po si?

Nga Dirk KURBJUWEIT & Ralf NEUKIRCH  
"Der Spiegel"

A mund të jetë kjo luftë një shans? Ekzistojnë shumë arsye, për të refuzuar një pikëpamje të tillë. E megjithatë, kjo gjë ka ndodhur herë pas here. Luftërat ndryshojnë lojërat; ato transformojnë shumë gjëra. Para së gjithash, ato e kthejnë në makth jetën e përditshme të njerëzve.

Por në aspektin politik, mund të ketë efekte pozitive të herëpashershme. A është Bashkimi Evropian një nga këto raste? Po, pretendon intelektual bullgar Ivan Krastev, studiues në Institutin e Shkencave Humane në Vjenë, dhe një nga mendimtarët kryesorë politikë të kohës sonë.

Para fillimit të luftës, Krastev shkruante se Evropa ishte në prag të rrënimit, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjes midis demokracive jo-liberale në Poloni dhe Hungari me Komisionin Evropian dhe me shumicën e vendeve të tjera anëtare të BE-së.

Por këto kohë ai është më optimist. "Lufta është një shans për Bashkimin Evropian"- deklaroi Krastev në një takim në Vjenë menjëherë pas pushtimit të Ukrainës nga Putin. Kompromiset, shtoi ai, ishin papritur të arritshme. Qeveria polake nuk mund të pretendojë më se kërcënim më i madh për sovranitetin e saj është Brukseli. Pasi ky kërcënim tani vjen nga Moska. Dhe BE-ja, e cila e kishte parë rolin e saj transformues të vendeve si Polonia, ka arritur tani të njohë vlerën e tyre në luftën kundër kërcënimit rus.

Krastev beson se Evropa mund të nxjerrë 2 leksione nga kjo luftë: Asnjë vend nuk mund t'i rezistojë i vetëm sfidave të jashtme, dhe sigurisht jo atyre ushtarake. Por shton ai, lufta nuk është një betejë për Evropën. Ndërsa ukrainasit po mbrojnë vendin e tyre, polakët dhe shtetet baltike janë të shqetësuar për vendet e tyre, një dëshmi thotë Krastev se shteti-komb është ende i rëndësishëm për identitetin politik të njerëzve.

Pajtimi i asaj që i bashkon me atë që i ndan evropianët, ka qenë misioni i madh i Evropës që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Sidomos Gjermania ka qenë prej kohësh një avokate e së përbashkëtës, e shprehur tek koncepti i një "bashkimi gjithnjë e më të ngushtë", një synim i shpallur që në Traktatin e Romës të vitit 1957.

Synimi përfundimtar është ai i



një shteti federalist, sovran si brenda po ashtu edhe jashtë. Qeveria aktuale në Berlin e ka mbështet hapur këtë qëllim. Megjithatë, Bashkimi Evropian është larg këtij vizioni. Sovraniteti vazhdon t'i takojë kryesisht shteteve kombëtare, dhe këto të fundit janë të etura të ruajnë atë që i veçon, veçanërisht anëtarët më të rinj në Evropën Lindore.

Dhe në Evropën Perëndimore, rritja e partive politike populiste dhe ri-fokusimi tek interesat kombëtare që ndodhën gjatë krizës në eurozonë dhe asaj të refugjatëve, e dobësuan prirjen drejt së zakonshmes. Utopia e një Evrope të brendshme sovraane nuk është më aq e fuqishme sa dikur.

Por utopia e një Evrope sovraane në skenën ndërkombëtare është ende e gjallë. Ideja është ajo e një BE-je që ndjek një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, dhe të një BE-je që është në gjendje të mbrohet vetë, edhe me mjete bërthamore. Një term tjetër për këtë është autonomia strategjike.

Por lufta në Ukrainë ka nxjerr në pah në mënyrë të pa mëshirshme faktin se kjo autonomi nuk ekziston aktualisht. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy do të donte ta drejtonte vendin e tij drejt BE-së, por vetëm SHBA mund të garantojë sigurinë reale në Perëndim. Evropa ka kohë që është struktur nën ombrellën mbrojtëse të Shteteve të Bashkuara, por kjo nuk është një strategji afatgjatë e besueshme. Ndaj sot kemi 2 zhvillime kontradiktore: Utopia e parë, pra sovraniteti i brendshëm, duket se e ka humbur tani për tani tërheqjen

e saj. Por Utopia e dytë, sovraniteti i jashtëm, është bërë gjithnjë e më i domosdoshëm.

"Ne evropianëve duhet të na vijë turp që jemi të paaftë të mbrojmë një projekt kaq të mrekullueshëm siç është BE-ja"- thotë Claudia Major, drejtuese e grupit kërkimor të politikave të sigurisë në Institutin Gjerman për Çështjet Ndërkombëtare dhe të Sigurisë (SWP) në Berlin, një think-tank i financiar kryesisht nga kancelaria.

Evropianët ia kanë lënë mbrojtjen e tyre NATO-s, e cila mund të përbëhet kryesisht nga shtetet kombëtare evropiane, por që vlen shumë pak pa SHBA-në shton Major. Dhe pas për më pak se dy vjet e gjysmë, amerikanët mund të zgjedhin sërish Donald Trump ose ndonjë president tjetër që mendon pak për NATO-n.

Për më tepër amerikanët, po fokusohen gjithnjë e më shumë tek kërcënimet që burojnë nga regjimi autoritar në Pekin. Në skenarin më të keq, BE-ja do të ishte kryesisht e pambrojtur kundër Rusisë dhe sundimtarit të saj, Vladimir Putin, që duket i aftë për çdo gjë. Major nuk ka shumë shpresë se BE-ja do të ishte veçanërisht e aftë pa "ombrellën mbrojtëse" amerikane.

Po çfarë duhet bërë? Major propozon që BE dhe NATO të ndërliken më mirë midis tyre. Njëkohësisht ushtritë e vendeve anëtare të BE-së duhet të përmirësohen, kryesisht në aspektet konvencionale, me tanke dhe helikopterë.

Anna Cavazzini e përshkruan veten si një evropiane e flaktë. Ajo do të donte të shihte zhvillimin e një shteti federal evropian, me një qeveri

evropiane dhe një parlament evropian.

Cavazzini, një politikane e Partisë së Gjelbër, ka qenë anëtare e Parlamentit Evropian për pak më pak se 3 vjet.

Ajo u zgjodh për herë të parë në krye të Komitetit të Tregut të Brendshëm dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Ajo beson se shtetet kombëtare duhet të heqin dorë nga akoma më shumë pushtet, dhe kërkon eliminimin e të drejtës së vetos së shteteve kombëtare. Sipas saj rregulli i shumicës duhet t'i zërë vendin atij të unanimitetit të detyrueshëm.

Sipas Canazzini vetëm kjo do të çonte drejt shndërrimit të BE-së në një shtet federal sovran.

Por historiani gjerman Heinrich August Winkler nuk sheh asnjë bazë për një sovranitet të brendshëm brenda Bashkimit Evropian. "S'mund të ketë sovranitet përtej sovranitetit popullor. Pasi kjo do të kërkonte një legjitimim të plotë të politikës evropiane përmes parlamentit në Strasburg. Dhe kjo nuk mund të ndodhë pasi një votë elektorale nga Malta ka 10 herë më shumë peshë në nivel evropian sesa një votë nga Gjermania.

Zgjidhja që propozon Krastev është pajtimi. "Nëse ne shqetësohemi vërtet për BE-në, duhet ta bëjmë pajtimin si prioritetin kryesor - thotë ai. Kjo nënkupton zbutjen e kontradiktave të brendshme të BE-së, edhe nëse ato nuk mund të zgjidhen plotësisht. Polonia dhe vendet e tjera duhet ta pranojnë se ka disa rregulla që vlejné për të gjithë.

Dhe BE-ja, thekson Krastev, duhet ta pranojë se shumë vende anëtare, nuk duan që identiteti i tyre kulturor të

"tretet" në Evropë. Po si të sheshohet kontradikta kryesore midis integritetit dhe demokracisë? Krastev thekson se shumë intelektualë liberalë e shohin demokracinë si një kërcënim për Evropën.

Tek e fundit, thonë ata, demokracia mund ta shkatërrojë BE-në në rast se qytetarët zgjedhin në krye qeveri anti-evropiane. Ose nëse votojnë kundër projekteve evropiane në referendume, siç ka ndodhur në Francë, Danimarkë dhe Holandë. Në Greqi, popullsia votoi kundër paketës shtrënguese të vendosur nga Brukseli gjatë krizës së euros dhe borxhit.


E megjithatë, Brukseli e detyroi qeverinë greke që të përmbushte kushtet e saj. Pra, çfarë është më e rëndësishme: Evropa apo demokracia? Për Krastev, përgjigja e kësaj pyetje fshihet tek praktika politike. Për të, Evropa është një vend negociimi. BE-ja, thotë ai, nuk po shkon drejt një pike përfundimtare, sigurisht jo drejt një shteti federal.

Ai e përshkruan unionin si një entitet të gjallë, që duhet të ndryshojë në varësi të sfidës. Përpjekjet e BE-së për të fituar legjitimitet përmes reformave të reja janë ç'orientuese. "Mbijetesa në një krizë është ajo që i jep Evropës legjitimitetin e saj"- thotë ai.

Utopia e Krastev: Evropa do të bashkëpunojë edhe më ngushtë pas luftës, thotë ai. Dhe ky integritet do të drejtohet nga shtetet anëtare. "Brukseli do të jetë një ofruar shërbimi për këtë integritet"- thekson ai.

Marrë me shkurtime





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Bujupi përforcon Llapin

**PODUJEVË, 19 QERSHOR** - Llapi ka prezantuar zyrtarisht transferimin më të ri të skuadrës, portierin Amrush Bujupin. Bujupi ka firmos kontratë dyvjeçare me fituesit e Kupës së Kosovës

në futboll. "Portieri Amrush Bujupi nënshkruan për 2 vite me Llapin. Kemi arritur marrëveshje 2 vjeçare me portierin shtatlartë, Amrush Bujupi, i cili në ekipin tonë vjen pas një eksperience tek

KF Drenasi", thuhet në njoftimin zyrtar të Llapit. Bujupi ishte pjesë e Drenasit për pesë vite radhazi, ku edhe barti shiritin e kapitenit të skuadrës. Portieri i gjatë 1.89 m është

bashkuar me ekipin në fazën përgatitore për ndeshjet ndërkombëtare dhe do jetë pjesë e skuadrës deri në vitin 2024. Llapi është ndër klubet më aktive në afatin kalimtar të verës.



## Në Kishnicë do të ndërtohet Kampi Multietnik

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Presidenti i FFK-së, Agim Ademi në kuadër të vizitave në stadiumet e futbollit për të parë nga afër gjendjen e tyre, të dielën ka qëndruar në Kishnicë, Gjilan, Ferizaj dhe Suharekë. Gjatë vizitës në dy fushat e futbollit që janë nën menaxhimin e minierës "Trepça"-Flotacioni Kishnicë, Ademi përshëndeti aktivitetin "Fun&Football" të organizuar nga KF "Shkëndija" nga Hajvalia, e ku morën pjesë më shumë se 250 fëmijë nga Hajvalia me rrethinë. Qëllimi i vizitës së kësaj FFK-së ishte që të shoh gjendjen e fushave të futbollit në Kishnicë, pasi

FFK-ja e ka ndërmarrë iniciativën dhe është e gatshme që t'i marrë nën menaxhim dhe shfrytëzim këto fusha nga miniera "Trepça", në mënyrë që aty të ndërtohet Kampi Multietnik, që është pjesë e strategjisë së re të masivizimit të futbollit. I pari i FFK-së ka bërë thirrje Bordit të Minierave "Trepça" dhe nga komunës së Graçanicës të punojnë së bashku në realizimin e këtij projekti. Kreu i FFK-së tutje ka vizituar edhe stadiumet në Gjilan, fushën me bari sintetik të ndërtuar nga federata dhe Stadiumin e Qytetit, pastaj stadiumin në Ferizaj dhe atë

të kampionit aktual, FC Ballkani në Suharekë. Ademi pas vizitave në këto stadione dhe duke parë gjendjen e tyre ka kërkuar nga MKRS-ja dhe komunat që të veprojnë sa më shpejtë në përmbylljen e të gjitha projekteve, në mënyrë që klubeve dhe tifozëve t'u krijohen kushte më të mira. Presidenti i FFK-së po ashtu ka kërkuar nga niveli lokal që të mbështeten klubet dhe t'u jepen stadiumet në shfrytëzim në afat të gjatë, pasi kjo do t'i jepte mundësi edhe FFK-së për të investuar me fondet e UEFA-s e FIFA-s. Ademi ka thënë se synimi i shtëpisë së futbollit kosovar



është që stadiumet e futbollit të jenë objekte moderne dhe komode edhe për tifozët, si dhe ndeshjet e Superligës të luhen nën dritën e

reflektorëve, pasi kjo do t'i jepte mundësi, por edhe do t'i nxiste sa më shumë qytetarë që të jenë të pranishëm në ndeshjet e futbollit.

## FGJK-ja organizoi me sukses 'Gjimnastradën e Kosovës 2022'

**PRISHTINË, 19 QERSHOR** - Federata e Gjimnastikës së Kosovës në hapësirat e objektit të Fakultetit Fizik dhe Sportit, të shtunën në një atmosferë të këndshme sportive ka organizuar me sukses, "Gjimnastradën e Kosovës 2022", Një aktivitet i pëlqyer nga fëmijët, prindërit dhe e gjithë audienca. Ky aktivitet i përmbushi pritshmëritë e veta, duke u nisur që nga numri i madh i pjesëmarrësve, performancave të punuara me aq shumë kreativitet nga trajnerët e klubeve, si dhe bindjen që fëmijët të bëjnë një aktivitet të rregullt sportiv. Të gjitha



klubet pjesëmarrëse e përfaqësuan veten e tyre në mënyrë më të bukur artistike, duke i ndërlidhur të tre

komponentët e gjimnastradës: muzikalitetin, koreografinë dhe ushtrimet akrobatike. FGJK-së ka

Dhe për këtë ata u vlerësuan me disa çmime, të cilat janë:  
- "Sinkronizimi më i Mirë" – Klubi i Gjimnastikës "Ardhmeria"  
- "Koreografia më e Bukur" – Klubi i Gjimnastikës "ELITA" Prishtinë – KGJE  
- "i Elegancës" – Klubi i Gjimnastikës "Kulina"  
- "Ekipi më Simpatik" – Klubi i Gjimnastikës "Skenderaj"  
- "Teknika më e Mirë" – Klubi i Gjimnastikës "Vushtrria"  
- "Performanca më Energjike" – OmniSport Prishtina  
- "Memorizimi më i mirë i Performancës" – Klubi i Gjimnastikës "Llapi"  
- "Kreativiteti" – Klubi i Gjimnastikes Fushe Kosove  
- "Kostumografia" – Klubi i Gjimnastikës "Universiteti"  
- "Artistik" – Klubi i Gjimnastikës Halil Alidema Gjilan – Viti  
- "Performuesit e së Ardhmes" – Klubi i Gjimnastikës Ritmike – POISE

falënderuar trajnerët e klubeve, të cilët po bëjnë një punë të madhe. Po ashtu Ministrinë e

Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Fakultetin e Edukimit Fizik dhe i Sportit.

## Zidane: Dua të vazhdojë punën si trajner me të njëjtën dëshirë dhe pasion

**MADRID, 19 QERSHOR** - Zinedine Zidane është ende pa ekip që kur u largua nga Real Madrid. Pavarësisht se nuk kishte një karrierë kaq të gjatë, talenti dhe cilësia e tij si trajner u demonstrua duke fituar tre tituj të Champions League me "Los Blancos". Tani, PSG dhe kombëtarja e Francës janë

opsionet e tij kryesore, por Zidane është ende i pavendosur për t'iu rikthyer zanatit të vjetër. Në një intervistë për Telefoot, legjenda franceze ka kujtuar disa momente të karrierës së tij në fushë. Por ai foli edhe për të ardhmen e tij si trajner, ku po e mban derën hapur,

por nuk e di se kur do të rikthehet, shkruan "Marca". "A mund të kontribuoj akoma si trajner? Po, shumë. Dua të vazhdoj sepse kam ende iluzionin, është pasioni im", theksoi Zidane. "Magjistari" zbuloi se cili ishte çelësi i suksesit të tij historik me Los Blancos. Nga lojtarët te

skudra që ai bashkoi për të përballuar një nga sfidat më të vështira për çdo trajner, drejtimin e Real Madridit. "Kemi punuar shumë, kemi pasur lojtarë të jashtëzakonshëm dhe një ekip që më ka ndjekur", shtoi ai. "Isha përgjegjës për shumë gjëra, por kisha një ekip të



madh pas meje". "Vetëm nuk do të ishte e mundur. Më duhet të rrethohem me njerëz me të cilët ndihem rehat. Nëse jo, nuk mund të funksionojë".



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government  
 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
 Ministry of Finance, Labour and Transfers  
 Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



### Njoftim për tatimpagues

#### Deklaroni të ardhurat dhe paguani tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimin dhe Kontributet Pensionale.

Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimet dhe Kontributet Pensionale, ATK do të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Andaj, ATK, u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e krijuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimit me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

*Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!*

Administrata Tatimore e Kosovës

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Mon Caffè AAB” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811848194 me pronar Adnan Ademi Vushtrri, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mon Caffè AAB” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811848194 Adnan Ademi Vushtrri ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Mon Caffè AAB” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811848194 Adnan Ademi Vushtrri the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Resmija Arifi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Besnik Gjini nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II, III të Sh.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- ▶ Isak Kukaj shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën , testin e maturës, certifikatën shmt " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ Lulzim Fetahu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.
- ▶ Nexhmedin Kacamak shpall të pavlefshme dëftesën shmt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Suzan Kovaci shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Mergim Asani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "7 Shtatori" Prishtinë.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

